

7 Mënyra për të Ndhmuar Fëmijën që Belbëzon hartuar nga Barry Guitar, Ph.D. dhe Edward G. Conture, Ph.D.

1. Fol me fëmijën ngadalë e duke bërë pushime të shpeshta. Fillo të flasësh vetëm pasi ke pritur disa sekonda pasi fëmija ka mbaruar së foluri. E folura jote e ngadaltë dhe e qetë është një ndihmë shumë më efektive se sa çdo lloj kriticizmi i tipit “fol ngadalë” apo “përsërite dhe një herë më ngadalë”.
2. Pakëso sa më shumë numrin e pyetjeve që i drejton fëmijës. Fëmijët flasin më lirisht kur shpjegojnë idetë e tyre, e jo ku u duhet tu përgjigjen pyetjeve të një të rrituri. Në vend që t’i bësh fëmijës pyetje, komento më mirë ato që ai ka thënë, duke i lënë të kuptojë që ti ke kuptuar atë që ai të tha.
3. Përdor mimikën dhe lëvizjet e trupit për t’i lënë të kuptojë fëmijës se je duke dëgjuar atë që ai po thotë e jo se si po e thotë.
4. Përpiqu t’i dedikosh fëmijës çdo ditë disa minuta ku t’i japësh gjithë vëmendjen tënde. Gjatë kësaj kohe lër fëmijën të zgjedhë atë që do të bëni. Lere të jetë në komandë të situatës e të vendosë nëse dëshiron të flasë apo jo. Kur të flasësh gjatë kësaj kohe, fol ngadalë dhe qetësisht, ndërthurur me pushime të shumta. Këto momente heshtjeje dhe qetësie mund të jenë të rëndësishme për të shtuar besimin në vetvete tek fëmijët e vegjël, sepse i lënë të kuptojnë se prindërit kënaqen me shoqërinë e tyre. Kur fëmija fillon rritet, kjo kohë e kaluar së bashku mund të kthehet në një periudhë ku fëmija ndjehet rehat duke folur për ndjenjat dhe eksperiencat e tij me prindin.
5. Ndhmo gjithë anëtarët e familjes të mësojnë të flasin me radhë e të dëgjojnë të tjerët. Fëmijët në përgjithësi, por veçanërisht ata që belbëzojnë, flasin më lehtësisht kur ndërpriten sa më pak dhe kanë gjithë vëmendjen e dëgjuesit.
6. Vëre mënyrës se si sillësh me fëmijën. Përpiqu ta shtosh kohën që kalon me të, duke i dhënë në këtë mënyrë mesazhin se ti po e dëgjon me vëmendje dhe se keni plot kohë për të folur. Mundohu të pakësosh kritikën, të folurën e shpejtë, ndërprerjet dhe pyetjet.
7. Mbi të gjitha jepi mesazhin se ti e pranon fëmijën ashtu si ai është. Mënyra më e mirë dhe më e fuqishme për ta ndihmuar është mbështetja që ti i jep kurdoherë, kur belbëzon apo jo.



*A Nonprofit Organization
Since 1947—Helping Those Who Stutter*

1-800-992-9392

www.stutteringhelp.org
www.tartamudez.org